



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 19300 Prot

Lezhë, më 08 / 11 / 2021

**NJOFTIM**

**Për thirrjen e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Lezhë**

**Drejtuar:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

**Për dijeni:** Kryetarit të Bashkisë Lezhë

**Për dijeni:** Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, si dhe në shkresën e Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr.prot 19237, datë 08.11.2021 “Për thirrjen e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak” njoftoj thirrjen e **mbledhjes jashtë radhe** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **mërkurë**, në datën **17.11.2021**, në orën **11:00**, me këtë

**REND DITE:**

1. Projekt-Vendim “Për heqjen e mandatit të anëtares së Këshillit të Bashkisë Lezhë, znj. Brunilda Tuku”
2. Projekt-Vendim “Për një ndryshim në VKB-në nr. 152, datë 28.10.2021 “Për përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet përfituese në ndërtesat (pallatet) të rindërtuara pas tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 në lagjen “Besëlidhja””
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore, për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve”.

**KRYETARI  
ERNEST RAKAJ**

